

Në bazë të nenit 51 alinea 2 të Statutit të Federatës Bjeshtkare të Maqedonisë së Veriut Nr.01-58/1 të dt.15.05.2019, Kryesia e FBMV në mbledhjen e mbajtur në dt.06.04.2021 nxorri këtë:

R R E G U L L O R E

e mbrojtjes medicinale në Federatën Bjeshtkare të Maqedonisë së Veriut

Neni 1

Rregullorja e mbrojtjes medicinale (në tekstin në vazhdim: Rregullorja) në Federatën Bjeshtkare të Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vazhdim: FBMV) bazohet në Ligjin e sporti (Fl.zyrtare nr.29/2002, 66/2004, 81/2008, 18/2011, 51/2011, 148/2013, 187/2013, 32/2014, 138/2014, 177/2014, 72/2015, 153/2015, 6/2-2016, 55/2016, 61/2016, 106/2016, 19o/2016, 98/2019 dhe 244/2019).

Me këtë Rregullore rregullohet kujdesi për ruajtjen dhe ngritjen e shëndetit të anëtarëve me mënyrën e kryerjes së kontrollimit shëndetësor të anëtarëve të shoqatave sportive-bjeshtkare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilën janë bashkuar për mes FBMV.

Neni 2

Rregullorja rregullon fusha me interes të veçantë në pjesën e mbrojtjes shëndetësore të anëtarëve, si vijon:

1. kontrollime medicinale:
 - kontrollime sistematike periodike,
 - kontrollime sistematike speciale,
 - roli i mjekut në selekcionet kombëtare dhe organizatat sportive,
2. mbrojtja nga dopingu,
3. mbrojtja nga keqpërdorimi i shtesave në ushqyerje.

Neni 3

Kjo Rregullore i përfshin të gjitha kategoritë e anëtarëve, si:

- pjesëmarrë në gara në disciplina sportive,
- pjesëmarrë në ngjitje në lartësi malore,
- anëtarë që janë përfshirë në sistemet për edukim në FBMV,
- anëtarë që për rekreativitet merren me bjeshtkari.

Neni 4

Anëtarët e regjistruar në FBMV prej të cilëve kërkohet ta përmbushin detyrimin ligjor për kontrollim mjekësor preventiv periodik prej mjekut specialist i medicinës së sportit ose specialist internist, që kontrollimet i kryejnë të paktën një herë në vit, u takojnë këtyre grupeve:

- pjesëmarrës në disciplina të garave sportive,
- pjesëmarrës në ngjitjet në bjeshtë në lartësi,
- anëtarë të përfshirë nëpër sistemet për edukim në FBMV.

Papatur vërtetim për kryerjen e kontrollitsistematik mjekësor dhe vlerësim të mjekut për gjendjen shëndetësore, anëtarët nuk mund të marrin pjesë në gara të organizuara nga FBMV apo nga cilido qoftë anëtar i FBMV, ose të marrin pjesë në program trajnimi në FBMV apo në ndonjërin nga anëtarët i FBMV, ose të marrin pjesë në ngjitje në bjeshtë të lartësive organizuar nga FBMV apo nga anëtarët a klub i saj.

Për anëtarët dhe klubet e tyre, të cilët nuk do t'u përmbahen dispozitivate të alinesë 1 e 2 të këtij neni, do të ngrihet procedurë disiplinore përkatëse para organeve të FBMV dhe para organeve kompetente shtetërore.

Neni 5

Anëtarët e regjistruar në FBMV, të cilëve u rekomandohet kontroll sistematik i rregull apo periodik, që kryhet më se paku një herë në 18 muaj, u përkasin këtyre kategorive:

- anëtarë të cilët për rekreativitet merren me bjeshtkari,
- fëmijë dhe të rinj.

Këta persona janë të detyruar gjatë anëtarësimit në klubet bjeshtkare anëtarë të FBMV dhe gjatë pagesës vjetore të nënshkruajnë deklaratë me të cilën deklarojnë se ndjehen të shëndetshëm dhe të aftë për të ushtruar aktivitete bjeshtkare rekreative. Me nënshkrimin të kësaj deklarate mund të bashkangjesin vërtetim se në një ent shëndetësor përkatës kanë kryer kontroll shëndetësor sistematik ose periodik. Si kontroll sistematik i kryer pranohen edhe kontrollet periodike të kryera nëpër organizatat e punës a institucione tjera. Për personat e mitur këtë deklaratë, si dhe lejimin për t'u marrë me aktivitete bjeshtkare, e nënshkruan prindi/kujdestari.

Detyrim i FBMV dhe i klubeve bjeshtkare, anëtarë të FBMV është që këtyre anëtarëve t'u rekomandohet kontrollim shëndetësor sistematik a periodik.

Neni 6

Në ngjarjet sportive të organizuara nga FBMV dhe nga anëtarët e saj në përputhje me Rregullat e garimit në ngjarje sportive, u lejonet pjesëmarrje vetëm në bazë të kontrollit mjekësor pozitiv nga mjek specialist i mjekësisë së sportit ose specialist-internist. Përmbushjen e këtyre kushteve e kontrollon delegati dhe organizatori i ngjarjes, për mes vërtetimit të listës së pjesëmarrësve të klubit, i cili është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve nga kjo Regullore.

Neni 7

Bursistët e Agjencisë për rini dhe sport, si dhe kandidatët për olimpiada, janë të detyruar të kryejnë testime dhe kontrollime mjekësore specialistike më së pak një herë në vit në Entin e mjekësisë sportive apo ent shëndetësor përkatës.

Neni 8

Sasia, përmbajtja dhe lloji i ekzagjërimit lidhur me kontrollet mjekësore specialistike në Entin e mjekësisë së sportit rregullohen me rregullat të veçanta, të cilat bashkërisht i nxjerrin Ministria e shëndetësisë dhe Agjencia për rini dhe sport në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 9

Për të përmirësuar mbrojtjen shëndetësore të anëtarëve, Kryesia e FBMV formon komision medicinal të përbërë nga pesë anëtarë.

Detyrë primare e Komisionit medicinal është ta udhëheqë politikën e përgjithshme të mbrojtjes shëndetësore dhe për mes instituteve të specializuara të zbatojë plane afatshkurta dhe afatgjata të mbrojtjes shëndetësore të anëtarëve në raport me përdorimin e shtesave, rehabilitimit të lëndimeve të anëtarëve, edukimin e anëtarëve lidhur me dopingun, përdorimin e shtesave në ushqyerje, si dhe të organizojë seminare në të cilat do t'i edukojë instruktorët dhe trajnerët me problemet në vijim lidhur me mbrojtjen shëndetësore të anëtarëve.

Neni 10

Kryesia e FBMV në ekip kombëtar mund të emërojë mjek, roli primar i të cilit është të punojë drejtpërdrejt me garistët dhe profesionistët sportivë në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të tyre.

Neni 11

Për shkak të mbrojtjes shëndetësore të anëtarëve të vet, anëtarëve të FBMV u rekomandohet të angazhonjë mjek të klubit, i cili do të kujdeset për shëndetin e anëtarëve në mënyrë dhe sasi të caktuar nga organ i ekzekutiv i FBMV apo klubit.

Në të gjitha garat vendore në organizim të FBMV apo anëtarëve të saj rekomandohet prania e mjekut- doktor i medicinës.

Detyrë e mjekut është në rast lëndimi a sëmundje të ndonjërit nga pjesëmarrësit të sigurojë ndihmë mjekësore në vendngjarje, t'i vlerësojë aftësitë e tij për të vazhduar pjesëmarrjen në ngjarjen dhe të merr pjesë në vendimmarrjen për vazhdim a ndërprerje të pjesëmarrjes për arsye shëndetësore.

Neni 13

Në gara ndërkombëtare organizatori është i detyruar të angazhojë numër të mjaftueshëm punëtorësh medicinalë (mjekë dhe infermjere), në pajtim me rregullat ndërkombëtare të caktuara nga organizatat ndërkombëtare në të cilat aderon FBMV, varësisht nga disiplina e garës. Është e nevojshme të sigurohet edhe automjet gjegjës për transportim eventual të të lënduarëve seriozë.

Neni 14

FBMV nxjerr rregullore për masat e mbrojtjes dhe parandalimit të dopingut dhe programe për anti-doping, me të cilën më përafërsisht rregullohet puna e FBMV në fushën e mbrojtjes së anëtarëve nga dopingu.

Neni 15

Interpretim të kuptimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje jep Komisioni medicinal i Kryesisë së FBMV.

Neni 16

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Regulloreje bën Kryesia e FBMV me propozim dhe miratim të Komisionit medicinal pranë FBMV.

Neni 17

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së saj.

Kryetari
Prof.D-r Jovica Ugrinovski

